



Në bazë të nenit 18 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22, 44 dhe 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-03 dt. 21.06.2016, nenit 17 pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 për Caktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrënimi për Kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve, Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, si dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-41460/22 dt. 25.02.2022, e pronarit Arben Arifi, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e aneks-ndërtesës me karakter të përkohshëm me destinim: Depo Afariste, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban- PZhU, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 08.03.2022, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore pronarit, Arben Arifi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-41460/22 dt. 25.02.2022, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e aneks-ndërtesës me karakter të përkohshëm me destinim: Depo Afariste, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban- PZhU, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 302-0 dhe 307-1 ZK. Bardhosh.

II. Lokacioni i parcelave kadastrale të lartcekura, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban- PZhU, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “gjelbërim”.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit- parcelave kadastrale të trajtuara, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - 302-0, ZK Bardhosh, me $S=13044m^2$, me pronar Arben Arifi, “Tokë Ndërtimore- Truall”;
 - 307-1, ZK Barchosh, me $S=2496m^2$, me pronar Arben Arifi, “Arë e Klasës 2”.
- Të drejtat pronësore-juridike për parcelat kadastrale janë private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njëjësive kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale 302-0, është e ndërtuar ndërtesa me karakter të përkohshëm me destinim depo afariste, e ndërtuar sipas Vendimit 05 nr. 351/02-42392/19 dt. 31.05.2019 për lejimin e ndërtimit, me sipërfaqe prej $2989.43m^2$;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka pjerrësi të vogël nga drejtimi veri-jug, medisnivel $\sim 0.4m$;
- Qasja ekzistuese në parcelat kadastrale është përmes rrugës ekzistuese;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelave kadastrale në fjalë, ekzistonë ndërtesa afariste, ekonomike;

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin- ndërtimin e aneks-ndërtesës me karakter të përkohshëm, bazuar në

parametrat uroan të planit dhe rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i aneks-ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelës, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit – “Situacioni”, bashkëngjitur këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Parcela kadastrale e trajtuara për realizimin e ndërtesës, konkretisht parcela kadastrale e përfshirë e trajtuar brenda vijës rregulluese, është:
 - 302-0, me $S=8'157m^2$;
 - 307-1, me $S=2'496m^2$;Sipërfaqe totale $S=10'653m^2$.
- Destinimi i shfrytëzimit të aneks-ndërtesës me karakter të përkohshëm të jetë për autolarje & market (sipas projekt propozimit të prezantuar);
- Etazhiteti i aneks-ndërtesës, të jetë P+0 me lartësi maksimale $H=5.81m$ nga niveli i terrenit (sipas projekt propozimit);
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë- gabarit të përdhësës ose suterren, sipas Planit dhe Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, është 0.4 (40%):
 $S = 10'653 \times 0.4 = 4261.20m^2$

Duke pas për bazë së në kuadër të këtij lokacioni, është ndërtuar ndërtesa me karakter të përkohshëm me po të nejtin destinim, në bazë të Vendimit për lejmin e ndërtimit 05 nr. 351/02-42392/19 dt. 31.05.2019, me sipërfaqe prej $2989.43m^2$, mbeten:

$$S = 4'261.20 - 2'989.43 = 1'271.77m^2$$

$$S = 813.70m^2 \text{ (sipas projekt propozimit për aneks-ndërtesën)}$$

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, sipas Vendimit të kryetarit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-185481 dt. 14.08.2015, është min 40%.
 $S=10'653 \times 0.4 = 4261.20m^2$

- Shfrytëzimi i nëntokës për bodrum nuk lejohet;
- Bazamenti i objektit – themelet mund të jenë nga betoni i armuar;
- Objekti me karakter të përkohshëm duhet të ndërtohet nga materialet montuese dhe lehtë demontuese si: hekuri, druri, plastika apo edhe ndonjë material i ngjashëm, si dhe nuk lejohen elementet muratore dhe betoni për ndërtimin e objektit;
- Bazuar në kriteret e Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik nr. 01-110288305 dt. 31.12.2014, distanca minimale në mes dy ndërtesave është 1H (Aty ku ka kthina primare), kurse distanca minimale nga kufiri i parcelës kadastrale- parcelës ndërtimore, është 0.5H, me kushtin e mos tejkalimit të distancës në mes dy ndërtesave, prej 1H. Me marrëveshje të fqinjëve, kjo distancë mund të jetë 0;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2015 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Ngritja e nivelit të përdhësës nga niveli i terrenit, nga rruga-niveli i terrenit, mund të jetë max. $0.3m$;
- Arkitektura e objektit t'i përshtatet ambientit që e rrethon;



- Qasja në kompleks, të jetë përmes rrugës ekzistuese, të paraqitur në Planin "Situacioni";
- Parkingu të planifikohet në atë mënyrë duke mos e tejkaluar kushtin prej 40% për gjelbërim, apo 30% nëse ndërtohet kulmi i gjelbër, duke organizuar 1VP/100m²;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për grumbullimi e mbeturinave;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Gjatë punimeve ndërtimore, t'i kushtohet kujdes i veçantë mbrojtjes së mjedisit.

V. **Deklarata e pronarëve** – në bazë të pikës 2 të nenit 12 të Rregullores nr. 01-110-288305 dt. 31.12.2014, me kërkesën për leje ndërtimit, duhet të prezantohet deklarata e pronarit të parcelës e vërtetuar te organi kompetent, me anë të cilës deklarohet se pronari do ta largoj objektin vet brenda 9 (tetë) ditëve, pas shfuqizimit të lejes ndërtimore;

VI. Pasi që parcelat kadastrale nr. 302-0 dhe 307-1 ZK Bardhosh, në bazë të certifikatave të njësive kadastrale, janë nën hipotekë, bashkë me aplikimin për leje ndërtimi, duhet të prezantohet pëlqimi nga pengmarrësi;

VII. **Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo Drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse.

Të dorëzohet e veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin- adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"- Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VIII. **Dokumentacioni ndërtimor** - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normat dhe standardet në fuqi për këto lloje të objekteve, si dhe të jenë në harmoni me rregullativën ligjore në fuqi, të dorëzohet në tre (3) kopje fizike dhe një (1) digjitale, në këtë përmbajtje:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m², me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;

- Përshkrimin teknik me paramase dhe paratogan të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zgjidhje,
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro-energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin e arkitekturës së qëndrueshme sipas Vendimit 01-031-185481 dt. 14.08.2015.

IX. Dokumentacioni ndërtimor për Masat Mbrojtëse nga Zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

X. Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit.

XI. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit

përcjellës, do të procedohet, nga kjo Drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore- këtë Vendim, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo Drejtori (kopje);
- Autorizimin për përfaqësim;
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve.

XII. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për Dhënien e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifën për Rregullimin e Infrastrukturës” 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor/projektin, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XIII. Vlefshmëria e Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimet për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Kërkuesi Arben Arifi nga Prishtina, me kërkesën 05-350/02-41460/22 dt. 25.02.2022, i është drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e aneks-ndërtesës me karakter të përkohshëm me destinim: Depo Afariste, me etazhitet P+0, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I të dispozitivit të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, kërkuesi ka prezantuar këtë dokumentacion: Certifikatat e Njësive Kadastrale për parcelat nr. 302-0 dhe 307-1 ZK Bardhosh, si dhe Kopjet e Planit; Vërtetim mbi obligimet tatimore të Arben Arifi me nr. 37901/22 dt. 22.02.2022, të lëshuara nga Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës; Vendim 05 nr. 351/0-42392/19 dt. 31.05.2019, për lejimin e ndërtimit të kompleksit me ndërtesë afariste të karakterit të përkohshëm- depo dhe administratë; Kopje e dokumentit të identifikimit të Arben Arifi dhe Naim Muçiqi; kopje e “Autorizim për Përfaqësim” lrp nr. 3896/2017 dt. 12.07.2017; Inçizimin gjeodezik për parcelën kadastrale, të punuar nga kompania gjeodete “Geo-Fa” shpk me nr. biznesi 810192625 dhe me nr. licence 57; Foto të lokacionit; Projekti ideor, të punuar nga kompania “AET Group” shpk me NUI 811485764.

Kjo Drejtori, gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë, ne arkivin e Drejtorisë së Urbanizmit, ka gjetur se: me Vendimin 05 nr 350/02-0061013/18 dt. 25.01.2019, në parcelën kadastrale 302-0 ZK Bardhosh, janë caktuar kushtet për ndërtimin e ndërtesës me karakter të përkohshëm- depo afariste; me Vendimin 05 nr. 351/0-42392/19 dt. 31.05.2019, është lejuar ndërtimi i ndërtesës me karakter të përkohshëm- depo afariste, me sipërfaqe prej 2989.43m².

Bazuar në sipërfaqet e parcelës 302-0 dhe parcelës që shtohet në këtë zgjidhje urbane 307-1, si dhe sipërfaqen e ndërtuar sipas Vendimit 05 nr. 351/0-42392/19 dt. 31.05.2019, për ndërtim mbeten edhe 1271.77m², ndërsa të propozuara janë 813.70m².

Ky organ, pas shqyrtimit të kërkesës UJ III. 350/02-41460/22 dt. 28.01.2022, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, ka vendosur njoftimin publik me datë 03.03.2022. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesëmbëdhjetë (5) ditë në lokacionin në fjalë, pra deri më dt. 07.03.2022 dhe meqë ndërkohë kjo Drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sugjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 “për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrënimi për Kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, Drejtorja e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të legjislacionit të lartpërmendur, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i lokacionit - "Situacioni".

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj Drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo Drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror- MMPHI.

Ky Vendim u shtyp në 4 (katër) kopje identike fizike dhe i dërgohet: Kërkuetit/ve; kësaj Drejtorie; Qendrës për Shërbim me Qytetarë; dhe në dosje të lëndës.

Kopje elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05 NR. 350/02-41460/22 DT. 08.03.2022

Zyrtari:

Arbër Hamidi

u.d. Udhëheqëse e Sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi





AET info: Ph.D. cand. Safete (Veliu) Rexhepi
 aetgroupks@gmail.com
 +383 44 930 430
 Rruga "B", Prishtine

Investitor: ARBEN ARIFI
 Ndertesë/emërtimi: DEPO
 Ndertesë/destinimi: Depo Afariste
 Etazhiteti: P+0

Faza: ARKITEKTURA
 Vizatimi: Situacioni Ngushte
 Për pjesa: 1:200
 Nr. fletës: 02

